

PROCESVERBAL

**TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME
“KOLAUDIM DHE RIMBUSHJE FIKESE ZJARRI”.**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “KOLAUDIM DHE RIMBUSHJE FIKESE ZJARRI”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të ndryshme - 98300000-6..

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,497,900 (Dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind) Lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të*

prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Në Nenin 82, të LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % i vlerës së përlogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë në konsideratë specifikën e shërbimeve objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur

ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se 39 % e fondit limit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë nga prodhuesi/distributori i autorizuar për shërbimet e kolaudimit dhe rimbushjes së fikseve të zjarrit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Deklarata nga prodhuesi ose distributori i autorizuar siguron që operatori ekonomik kryen shërbimet e kolaudimit dhe rimbushjes së fikseve sipas standardeve teknike të prodhuesit, me materiale dhe procedura të certifikuara. Kjo garanton cilësinë, sigurinë dhe përputhshmërinë me kërkesat e kontratës, duke shmangur çdo ndërhyrje të pasaktë apo të pasigurt në pajisjet kundër zjarrit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur dhe te paraqesë Certifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si me poshtë:

- a) ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”.
- b) ISO 14001: “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”.
- c) ISO 45001: “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”.

ISO 9001 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, është e nevojshme për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse produktet dhe shërbimet e marra nga furnitorët janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 14001 - Sistemi i Menaxhimit Mjedisor, është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politiken mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

ISO 45001 - Standardi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë së Punës, është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Argumentimi:

Kërkesa për këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, dhe nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij minimalisht 3 (tre) punonjës të certifikuar për shërbimin e mirëmbajtjes dhe kolaudimit të pajisjeve kundra zjarrit sipas objektit të prokurimit nga ent certifikues i akredituar ose nga kompani prodhuese pajisjeve kundra zjarrit.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- Kontrate pune
- Certifikatë përkatëse
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën periudhën **Mars 2025 - Maj 2025.**

Argumentimi:

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe me nenin 40, pika 5, germa c, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Në zbatim të këtyre dispozitave, Operatori Ekonomik duhet të demonstrojë përpara Autoritetit Kontraktues se disponon kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore të specializuara, në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimit që do të ofrohet, duke garantuar kështu realizimin me cilësi, siguri dhe brenda afateve të kontratës.

Konkretisht:

Kërkesa për të pasur minimalisht 3 (tre) punonjës të certifikuar për mirëmbajtjen dhe kolaudimin e pajisjeve kundër zjarrit bazohet në natyrën e specializuar dhe të ndjeshme të shërbimit objekt prokurimi. Prania e këtyre punonjësve garanton realizimin e kontratës me cilësi dhe siguri të lartë, duke mundësuar mbulim të plotë teknik në çdo fazë të shërbimit – nga kontrolli e mbushja deri te kolaudimi dhe transporti i sigurt i pajisjeve.

Gjithashtu, sigurohet vazhdimësia e shërbimit edhe në rast mungese apo angazhimi të njërit prej tyre. Duke qenë se KESH sh.a. është institucion i një rëndësie të veçantë, marrja e këtyre masave parandaluese është thelbësore për mbrojtjen e aseteve dhe realizimin e shërbimit nën mbikëqyrjen e personelit të certifikuar.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 2 (Dy) automjete ATP, në pronësi të shoqërisë apo të marrë me qira.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- Për secilin nga automjetet ATP, OE duhet të paraqesë :
- Leje e Qarkullimi, Siguracionin dhe Kolaudimin të vlefshme të automjetit në pronësi të shoqërisë.
- Në rastin kur automjeti është marrë me qira, duhet të paraqitet Kontrata noteriale e marrjes me qira, si dhe Leje e Qarkullimit, Siguracionin dhe Kolaudimin të vlefshme të automjetit.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në

dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për të pasur minimalisht 2 (dy) automjete ATP është thelbësore për transportin e sigurt të pajisjeve kundër zjarrit që përmbajnë lëndë nën presion ose të rrezikshme. Këto automjete garantojnë përmbushjen e standardeve teknike dhe ligjore për transport të kontrolluar dhe të certifikuar. Prania e dy mjeteve siguron vazhdimësinë e shërbimit edhe në rast defekti apo nevojë paralelisht në disa pika. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për një institucion si KESH sh.a., që ka asete kritike dhe kërkon shërbim pa ndërprerje dhe me siguri maksimale.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 2 (dy) makineri /pajisje të lëvizshme të cilat të vendosen në mjetet ATP dhe të mundësojnë kryerjen e të gjithë shërbimit të kërkuar (kolaudim dhe rimbushje) në çdo objekt të AK sipas grafikut të shpërndarjes dhe në prani të specialistëve të ngarkuar nga AK.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

Për secilin nga makineritë/pajisjet, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë :

- a) Katalog /fragmente të katalogut të pajisjeve ku të përshkruhet pajisja dhe proceset e saj të punës për mirëmbajtjen dhe rimbushjen e fiksive të zjarrit.*
- b) Dokumentin e blerjes/zhdoganimit të makinerive/pajisjeve.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Këto kritere janë kërkuar që të bërë të mundur që OE të dëshmojë kapacitetet teknike, të cilat do të bëjnë të mundur kryerjen në kohe dhe me saktësi të shërbimeve të nevojshme në procesin e zbatimit të kontratës dhe periudhës së garancisë teknike.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, duke përllogaritur nevojat specifike të shërbimeve, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Kudo që përmendet Standardi EN do të pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve Europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Njësia e Prokurimit.